



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 538 / Prot.
8

Durrës, më 10.02.2025

VENDIM

Nr. 13, datë 10.02.2025

PËR

"MIRATIMIN E SAKTËSIMEVE NË KURRIKULËN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE BACHELOR NË "SHKENCA NDËRKOMBËTARE DHE DIPLOMATIKE" PRANË DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE POLITIKE, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS", PROGRAM NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E GJENOVËS, ITALI".

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; Urdhrit të MAS Nr.323, datë 29.06.2023; të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 71, datë 25.11.2022; të shkresës Nr. 190 prot., datë 27.03.2024, si dhe të shkresës Nr.398 prot., datë 29.01.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 10.02.2025 Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,

V E N D O S I:

1. Miratimin e saktësimeve në kurrikulën e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatiqe" pranë Departamentit të Shkencave Politike, në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", sipas marrëveshjes me programin në bashkëpunim me Universitetin e Gjenovës, Itali, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët;
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore, FSHPJ;
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

